



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 17, pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 17 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikimin hapësinor dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 15.2.2016, miratoi këtë

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDRYSHIMIN - PËRSHTATJEN E PROFILIT TË RRUGËS "F-F" NDËRMJET BLOQEVE "B 1" DHE "B 2", NË LAGJEN "LAKËRISHTA" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për dhënie e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F-F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2", e cila gjendet në kuadër të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë.

Neni 2

Ndryshimi i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, ka të bëjë me ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F-F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2", ndryshim i cili do të vlejë deri në revidimin dhe miratimin e planit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në harmoni me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për planifikimin hapësinor.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjës Kryetari i Komunës dhe Drejtoria kompetente për planifikim e Komunës.

Neni 4

Organet e tjera të Administratës do t'i kryejnë veprimet përkatëse nga përgjegjësitë e tyre me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa grafike e profilit të rrugës së ndryshuar.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes dhe ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 nr. 031-52761, më 04.03.2016.



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl

ARSYETIM

IVENDIMIT PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDRYSHIMIN - PËRSHTATJEN E PROFILIT TË RRUGËS "F-F" NDËRMJET BLOQEVE "B 1" DHE "B 2", NË LAGJEN "LAKËRISHTA" NË PRISHTINË

Komuna e Prishtinës, gjegjësisht Drejtoria e Urbanizmit, mbështetur në kërkesën e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, nr. 05-351-36870, të datës 16.2.2015, ka miratuar kërkesën e investitorit "ENK Grup" për asfaltimin e profilin të rrugës "F-F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2, leja nr. 351-36870, dt. 18.2.2015.

Gjithashtu, investitori ka bërë kërkesë për ndarjen e parcelës nr. P-71914059-07226-1, në parcelën ku shtrihet objekti i cili është i paraparë për "Raiffeisen Bank", si dhe pjesës së parcelës që është e dedikuar për rrugë, e cila duhet të kalojë në pronësi të Komunës, si dhe regjistrimin në librat e kadastrave të këtyre parcelave. Kjo kërkohet sepse objekti i ndërtuar është i dedikuar për "Raiffeisen Bank" në Kosovë, dhe ka ardhur koha për bartjen e pronësisë së objektit nga pronari aktual në pronësi të "Raiffeisen Bank", mirëpo mos parcializimi dhe mungesa e regjistrimit në librat e kadastrave, e pamundëson këtë transfer, por edhe finalizimin e kontratës.


Gjendja faktike e objekteve përreth e pamundëson realizimin e rrugës, sepse objekti i "ENK Grup" i dedikuar për "Raiffeisen Bank", me leje të ndërtimit nr. 05-351-14249, dt. 8.8.2008 (pjesa e nëntokës me etazhitet - 6 B), dhe nr. 05-351-17910, dt. 9.8.2012 (pjesa mbi tokë e objektit afarist administrativ me etazhitet P+7), në pjesën e nëntokës tejkalon vijën ndërtimore të planifikuar sipas planit rregullues, si dhe dikton kushte të reja të shkëmbimit të pronave mes Komunës së Prishtinës dhe investitorit "ENK Grup". Pa këtë shkëmbim nuk është i mundur realizimi i plotë i kësaj rruge, por as parcelimi i parcelave.

Bazuar në këtë, Kryetari i Komunës propozon që të miratohet ndryshimi i përkohshëm i gjerësisë së rrugës, duke miratuar dhe lejuar ndërtimin e rrugës në gjerësi të cilën e lejojnë kushtet faktike, mbështetur në projektin e përshtatur të rrugës me gjatësi rreth 155 m, duke filluar nga rruga ekzistuese "Robert Dol" dhe në brendësi të bllokut, si dhe lejin e shkëmbimit dhe rregullimit të hapësirave mes Komunës së Prishtinës dhe investitorit "ENK Grup", si dhe parcelimin dhe regjistrimin e këtyre parcelave.

Me miratimin e këtyre ndryshimeve, do të mundësohet edhe shpronësimi i pjesëve të caktuara të kësaj parcele që janë dedikuar për rrugë, të cilat do të kalonin në pronësi të Komunës, si dhe do të mundësohej parcelimi i këtyre pjesëve dhe vendosja në regjistrat e kadastrave të Komunës, e veçanërisht e objektit sipas kërkesave të investitorit.

Me këtë vendim do të krijonim kushte për një investim të madh që "Raiffeisen Bank" planifikon të realizojë në komunën tonë, investim i cili i tejkalon dhjetëra milionë euro.

Të gjitha këto ndryshime janë paraqitur edhe në mënyrë grafike.



Gjendja Faktike - Realizimi i objektit të Raiffaisent Bank në kuadër të kompleksit të " ENK INVEST GROUP ".

Gjendja e propozuar.

